

Objektivat Universitare

Qëllimi ynë është të promovojmë vlerën, dijen, shkencën, kulturën, të përgatitim talente, të krijojmë kompetenca dhe të mbështetim ndërmarrjet e punësimin.

Të gjithë së bashku të përpiqemi çdo ditë që Universiteti ynë të mbetet model i vlerave, i kontributeve të shumta, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e qëndrueshëm të shoqërisë ku jetojmë, studiojmë dhe veprojmë si institucion akademik.

Komuniteti ynë akademik është i formuar nga profesorë, lektorë, profesionistë. Të gjithë këta elementë nuk mund të bëjnë dot pa njëri-tjetrin, duke shërbyer si pjesë vitale e zhvillimit të Universitetit.

Profesorët dhe lektorët kanë si mision transmetimin e dijeve te studentët. Ata janë të drejtë, të duruar, të gatshëm për të dhënë çdo shpjegim të kërkuar. Të gjithë bashkë kërkojmë mënyra për të eksploruar të panjohurën e për t'i dhënë zgjidhje çdo problemi, për ta kthyer në mision mbajtjen në jetë të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për ta vazhduar traditën tonë 50-vjeçare në përgatitjen e profesionistëve brilantë.

OFERTA UNIVERSITARE



**UNIVERSITETI
“EQREM ÇABEJ”
VITI AKADEMIK
2017-2018**



**ZGJIDHNI
UNIVERSITETIN
“EQREM ÇABEJ”**

**PËR NJË KARRIERË
TË SIGURT**



Programet Bachelor Fakulteti i Shkencave të Natyrës

- **Matematikë & Informatikë**
- **Teknologji Informacioni**
- **Matematikë - Fizikë**
- **Fizikë-Teknologji Informacioni**
- **Biologji - Kimi**
- **Infermieri e Përgjithshme**
- **Infermieri - Mami**

Programet Master Fakulteti i Shkencave të Natyrës

- **Matematikë - Informatikë**
- **Matematikë-Fizikë**
- **Edukim Mjedisor &
Teknologjik**

Programet Bachelor Fakulteti i Ekonomisë

- **Kontabilitet – Financë**
- **Administrim Publik**
- **Turizëm**

Programet Master Fakulteti i Ekonomisë

- **Kontabilitet – Financë**
- **Administrim Publik**
- **Turizëm**

Programet Bachelor & Master Fakulteti i Shkencave

- **Histori - Gjeografi**
- **Gjuhë - Letërsi Shqipe**
- **Gjuhë Angleze**
- **Gjuhë Italiane**
- **Histori & Gjuhë Italiane**
- **Gjuhë - Letërsi &
Qytetërim Grek**
- **Mësuesi Arsimit Fillor**
- **Mësuesi Arsimit
Parashkollor**
- **Administrim i Pasurive
Arkeologjike**
- **Menaxhim i Trashëgimisë
Kulturore**
- **Studime Doktorale në
Albanologji**